



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.0.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
PRISHTINËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit Ardita Salihu si dhe anëtarët Selvete Foniqi dhe Elvir Krasniqi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Zuka Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	33
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	34
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	36
Shtojca IV: Letër e Konfirmimit	43

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Prishtinës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 15.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Në hollësi, shih Shtojcën 1.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes


Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se komuna kishte klasifikuar disa shpenzime në kode jo adekuate. Ndërsa, në fushën e pasurisë, komuna edhe pse ka bërë progres në evidentimin e pronave, megjithatë nuk kishte evidentuar të gjitha pasuritë në regjistrin kontabël.

Për më gjerësisht, shih kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV-të 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se kemi hasur një vlerë prej 1,837,842€ shpenzime të ekzekutuara nga kodi i investimeve kapitale, të cilat i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime². Shkakua ishte buxheti i kufizuar për mallra dhe shërbime dhe të njëjtat ishin të aprovuara me ligjin e buxhetit si projekte kapitale.

Përkundër progresit të bërë në regjistrim të pasurisë, nga investimet kapitale të vitit nuk ishin të përfshira në regjistrin e pasurisë blerjet prej 112,605€, duke nënvlerësuar kështu pasurinë për këtë shumë. Derisa, transferi prej 1,000,000€ për Termokos ishte regjistruar si pasuri në përdorim nga komuna, si dhe transferi prej 1,000,000€ për fabrikën e ujit Shkabaj ishte regjistruar si investim në vijim. Vlera e këtyre projekteve duhet të regjistrohet si pasuri tek përfituesit e transfereve kapitale dhe të largohen nga regjistri i pasurisë nga regjistrat kontabël të komunës.

Opinionin ynë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryetari i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prishtinës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

² Shpenzimet kishin të bëjnë me mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, trajtimin dhe vaksinimin e qenve, dezinfektim hapësinor, organizime festive e dekorime të qytetit si dhe ekzekutim i vendimeve gjyqësore për lëndë të natyrës së shërbimeve.

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat e Ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Kërkesat e Ligjit Vjetor të Buxhetit;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013, nr.02/2013 dhe 01/2017;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të cilësisë së PFV-ve, një numër i këshillave që i kemi dhënë në Memorandumin e Auditimit të datës 23.12.2016 janë adresuar gjatë procesit të përgatitjes të tyre. Por, çështje ende e pa adresuar ishte se komuna nuk ka të angazhuar Zyrtarin Kryesor Financiar (ZKF). PFV-të nënshkruhen nga drejtori i financave, që është në kundërshtim me LMFP dhe rregullën 01/2017 të Thesarit³.

³ Pasqyrat duhet të nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ZKF si dhe çdo organizatë buxhetore, duhet ta ketë Zyrtarin Kryesor Financiar me status të nëpunësit civil.

Në draft PFV ishte e nevojshme të bëhen disa korigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, dhe të cilat ishin adresuar në pasqyrat finale:

- Tek neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, kolona e buxhetit final, tek hyrja dhe dalja e parasë së gatshme, nuk ishte paraqitur shuma prej 50,000€ e planifikuar nga huamarrjet;
- Tek po e njëjta pasqyrë, vlerat e paraqitura tek buxheti final sipas kategorive ekonomike fillimisht ishin mbivlerësuar për 233,717€. Kjo meqë buxheti final i pagave ishte 27,944,188 derisa është deklaruar si 28,144,268€ dhe buxheti final i mallrave dhe shërbimeve ishte 7,475,737€ dhe është paraqitur 7,506,675€ si dhe buxheti final i shpenzimeve komunale është 1,791,300€ dhe është paraqitur në vlerë 1,793,000€;
- Formati 2016 i pasqyrave kërkon që tek neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, hyrja e parasë së gatshme të ndahet sipas llojit të tyre, pra nëse të hyrat janë tatimore apo jo tatimore. Shuma e paraqitur si tërësi ishte e saktë si tek buxheti fillestar, ai final si dhe tek realizimi, por vlerat duhej të ndaheshin në atë mënyrë që tatimi në pronë të dallohet prej taksave tjera;
- Pranimet dhe pagesat jashtë LIVTh tek Biblioteka e Qytetit dhe Teatri Dodona të shpalosen dhe të jepen shpjegime të mjaftueshme për rrjedhat e transaksioneve të ndodhura; dhe
- Raporti i numrit të të angazhuarve jashtë listës së pagave dhe atyre nën shërbime të veçanta të paraqitura në nenin 26 dhe 27 të pasqyrave financiare nuk ishin të ndara sipas programeve të organizatës, ashtu siç kërkohet me rregulloren 01/2017.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve mund të ishte menaxhuar në mënyrë më cilësore me rastin e draftimit të parë të tyre.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç disa gabimeve dhe mangësive jo materiale, si më poshtë:

- Tek neni 13, vlera e palëve të treta prej 87,244€, nuk ishte procesuar në modulën përkatës të SIMFK⁴-së si shpenzim, por e njëjta ishte paraqitur në pasqyra; dhe
- Nuk janë evidentuar llogaritë e arkëtueshme nga taksat në ushtrimin e veprimtarive afariste.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk ishte bërë raportimi i progresit të investimeve kapitale mbi 10,000. Përveç kësaj, si kërkesë e raportimit të jashtëm, nuk ishte plotësuar dhe dorëzuar pyetësori i vetvlerësimit në MF.

⁴ Sistemi Informativ për menaxhimin e Financave të Kosovës.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e mësipërme rekomandimet tona janë:

- Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i adresuar shkaqet në Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Procesi buxhetor duhet të jetë reflektim i shpenzimeve reale në mënyrë që të gjitha shpenzimet të klasifikohen sipas kodeve adekuate. Sa i përket institucioneve vartëse, ne do të inkurajonim të bëhet nga një auditim i brendshëm për të marrë siguri të mjaftueshme rreth mënyrës së mbledhjes së të hyrave dhe krijimit të shpenzimeve, të paktën për dy vitet paraprake.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të siguroj se gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së ZKF-së. Gjithashtu, para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre, me theks të veçant tek evidentimi dhe regjistrimi i palëve të treta si dhe llogarive të arkëtueshme nga taksat në biznes.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komunën e Prishtinës që të menaxhoj në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, si një tregues se menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të auditimit të brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në komunë vërehet një qeverisje e përmirësuar, veçanërisht tek raportimi i një numri aktiviteteve si dhe hapa drejt një transparence mbi zhvillimet dhe arritjet drejt ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Platforma digjitale për pjesëmarrje publike, realizimi i rreth 24 debateve publike në vende të ndryshme të komunës, hartimi i planit për transparencë, plani i integritetit si pjesë e proceseve të përgjithshme planifikuese dhe raportet publike të drejtorive për punët e kryera, janë përkushtimet tjera drejt një llogaridhënie dhe transparence të shtuar ndaj publikut.

Më tej, komuna ka bërë punë të mirë kryesisht në reduktimin e shpenzimeve operative (ato të udhëtimeve zyrtare, shpenzimeve komunale dhe shpenzimeve për shërbimet kontraktuese tjera). Po ashtu, veprime të konsiderueshme janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuese me donatorë të ndryshëm për ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarë. Komuna ka vendosur një praktikë të mirë dhe ka arritur që pagesat nga donatorët e jashtëm në shumë totale prej 347,497€ që kishin të bëjnë me pagesa për paga, mallra si dhe për projekte kapitale t'i kanalizoj përmes LLVTH.

Me gjithë zhvillimet pozitive, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak, përcaktimit të objektivave strategjike ndër departamentale, përmbushjes së kërkesës për vetëvlerësim, menaxhimit të rreziqeve dhe disa çështjeve lidhur me menaxhimin financiar.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të komunës ka rezultuar në 36 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si të zbatohen rekomandimet.

Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një qasje shumë më serioze dhe angazhim më i lartë në adresimin e çështjeve dhe rekomandimeve të dala në raportin e kaluar të auditimit, ku rreth 70% prej tyre janë zbatuar apo janë në proces e sipër. Vitin e kaluar ishte zbatuar vetëm një rekomandim. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, 11 rekomandime janë zbatuar, 13 ishin në proces si dhe 12 nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Me gjithë progresin thelbësor në zbatimin e rekomandimeve, nuk është zbatuar ndonjë proces formal i monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit, dhe kjo tregon se funksioni i llogaridhënies në këtë fushë nuk është aplikuar sa duhet.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve tregon se disa nga mangësitë e identifikuar ende nuk janë korrigjuar, dhe kjo ka rezultuar në:

- parregullsi në certifikim të pagesave dhe klasifikime jo adekuate;
- mos funksionim adekuat i auditimit të brendshëm; dhe
- mos shpalosje e llogarive të arkëtueshme nga taksat në biznes.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse një numër rekomandimesh nga viti i kaluar nuk janë zbatuar, si dhe të sigurojë që plani i veprimit i përgatitur pas marrjes së këtij raporti, do të inkorporoj të gjitha rekomandimet e dhëna dhe do të përcaktoj saktë afatet kohore, masat dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu, kryetari, duhet të zbatoj masa përgjegjësie ndaj personave të ngarkuar për zbatimin e masave përmirësuese të proceseve, për çështjet e ngritura nga auditimi.

2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi planifikuar të testojmë cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri.

Çështja 4 - Mos dorëzimi i pyetësorit të vetëvlerësimit - Prioritet i mesëm

E gjetura	Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të përmbushë obligimin për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe dorëzimin e tij në MF.
Rreziku	Mos plotësimi i kërkesave të MFK-së, ndikon në pamundësinë e komunës për të identifikuar dobësitë eventuale të sistemit të kontroleve të brendshme dhe efektivitetin dhe përshtatshmërinë e këtyre kontroleve, si dhe të propozoj masa drejt përmirësimeve për fushat në të cilat janë identifikuar mangësitë.
Rekomandimi 4	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse ky detyrim i përcaktuar me kornizën e MFK-së nuk është përmbushë, dhe të siguroj se lista kontrolluese e vetëvlerësimit dhe adresimi i kërkesave të këtij pyetësi të bëhet brenda afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e duhur. Një mekanizëm i cili do të konfirmonte saktësinë e pohimeve të listës kontrolluese dhe relevancën e dokumentacionit mbështetës, duhet të vendoset, dhe ne sugjerojmë që para se të dorëzohet në MF, ky pyetësor t'i nënshtrohet një rishikimi final nga auditimi i brendshëm.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit operon komuna dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha komunat janë të obliguara të përgatisin dhe përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Çështja 5 - Planet dhe objektivat strategjike - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna posedon Planin Zhvillimor Komunal 2012-2022. Edhe pse dokumenti është mjaft voluminoz, nuk ka të llogaritur ndonjë kosto për zbatimin e tij dhe nuk është i përcaktuar ndonjë afat për arritje të objektivave apo monitorim të tyre. Komuna ka sqaruar se janë në proces të hartimit të hartës zonale dhe se ky plan zhvillimor komunal do të revidohet për të inkorporuar edhe ndryshimet në sferën e ekonomisë. Mirëpo, nuk është vërejtur se ekzistojnë plane tjera operative.
- Rreziku** Mungesa e përlllogaritjes së kostove të strategjisë dhe paqartësia mbi përcaktimin e objektivave të matshme për drejtori, bën të pamundur që të përcillet përmbushja e tyre në pikëpamje të vizionit të komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që si planet strategjike, ashtu edhe ato operative, përmbajnë objektiva të qarta dhe janë në harmoni me vizionin dhe politikat e qeverisjes së përgjithshme komunale. Kjo do të mundësonte vlerësim të drejtë të rezultateve dhe rishikim të objektivave departamentale, aty ku është e nevojshme.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Nga aspekti i raportimit menaxherial është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 6 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Përkundër që është deklaruar për raportim mujor, komuna nuk ka ofruar raportet të cilat drejtoritë dorëzojnë tek menaxhmenti i lartë për të rishikuar nëse është adresuar rekomandimi i vitit paraprak mbi formën dhe kërkesat për përmbajtjen e tyre, nëse të njëjtat janë cilësore dhe ofrojnë shënime të mjaftueshme mbi aktivitetet operacionale dhe financiare komunale.
- Rreziku** Mungesa e raportimeve nga bartësit e njësive administrative reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë. Ato gjithashtu rrisin rrezikun për shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të siguroj se raportimi nga drejtuesit e departamenteve komunale është i mjaftueshëm, cilësor dhe me kohë, në mënyrë që të rritë aftësinë vendimmarrëse dhe të reagimit me kohë ndaj situatave të cilat mund të kërcënojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve financiare dhe operative të komunës.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon në përbërje prej katër auditorëve (përfshirë drejtorin e njësisë). Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe operative të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të auditimit të brendshëm mund të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv. Në lidhje me këtë, ne marrim në konsideratë punën e auditorëve të brendshëm, veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë në adresimin e rekomandimeve si dhe angazhimet e komitetit të auditimit.

Çështja 7 - Mungesë e aktivitetit të NjAB - Prioriteti i lartë

E gjetura Gjatë vitit 2016, përveç një auditimi të veçantë të kërkuar nga kryetari i komunës mbi procedurat për tjetërsim të pasurisë jo financiare në Qendrën e Mjekësisë Urgjente, NjAB nuk ka kryer asnjë auditim të brendshëm.

Draft plani strategjik dhe ai vjetor për vitin 2016 nuk ishin nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Auditori i brendshëm për këtë arsye, pa plan të aprovuar për auditime, nuk kishte kryer më auditime. NjAB ka raportuar për tremujorin e parë, të tretë dhe të katërt 2016 në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQH/AB). Njëherit, në raportime theksohet edhe mos funksionimi i kësaj njësie dhe sfidat mes menaxhmentit dhe NjAB. Nuk ka pasur ndonjë reagim nga NjQH/AB.

Në mungesë të kryesuesit të komitetit i cili kishte dhënë dorëheqje në vitin 2015, komiteti nuk kishte mbajtur ndonjë mbledhje dhe njëkohësisht nuk është caktuar ende kryesuesi i ri.

Rreziku Mos funksionimi adekuat i sistemit të auditimit të brendshëm, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve kyçe financiare, sidomos në një ambient organizativ si Komuna e Prishtinës, ku ka një numër të shkollave, institucioneve vartëse apo edhe njësie tjera të cilat krijojnë të hyra dhe shpenzime të cilat do të duhej t'i nënshtroheshin një numri auditimesh të kohëpaskohshme. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.

Rekomandimi 7 Për të arritur përfitimet maksimale nga auditimi i brendshëm, kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që të zgjidhë problemin e funksionimit të plotë të NjAB, ndërkohë që përfitimet nga këto shërbime janë minimale dhe gati pa kurrfarë ndikimi.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket menaxhimit financiar dhe zbatimit të kontrolleve, pagesat bazuar vetëm në marrëveshje bashkëfinancimi, mos realizimi i projekteve kapitale sipas buxhetit dhe pagesat direkte nga Thesari mbeten sfidat më të theksuara. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet në disa fusha të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave përmes vendimeve gjyqësore. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek projektet kapitale, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, kontratat për shërbimet e veçanta dhe tjera.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Gjithsej të hyrat vetjake:	30,000,000	29,950,000	24,243,686	18,035,992	19,904,415
Tatimi në pronë	5,350,000	5,350,000	7,176,272	5,623,478	5,649,337
Taksat komunale	24,650,000	24,600,000	17,067,414	12,412,514	14,255,078

- Gjatë vitit 2016, komuna ka shënuar trend pozitiv sa i përket inkasimit të të hyrave vetjake. Janë mbledhur 24,243,686€ të hyra vetjake, që paraqet një performancë për 34% më të mirë se në vitin e kaluar. Sipas planit, ekzekutimi i të hyrave ishte 81% e buxhetit final. Kjo për shkak se planifikimi ishte shumë më ambicioz se plani i vitit paraprak, me një diferencë prej 2,787,391€;
- Ndryshimi i buxhetit final prej atij fillestar paraqet një reduktim prej 50,000€ (shih tabelën e mëposhtme) ngaqë kjo vlerë është ribuxhetuar si huamarrje me vendim të Kuvendit Komunal të datës 27.05.2016 dhe ka të bëjë me projektin e efijencës së energjisë me bankën gjermane (KFW); dhe

- Sipas ligjit të buxhetit, e gjithë kategoria e investimeve kapitale është planifikuar të mbulohet me të hyra vetjake.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁵	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	65,883,762	73,432,964	58,774,174	64,525,481	56,801,207
Granti i Qeverisë -Buxheti	35,883,762	35,683,451	35,638,240	35,573,654	40,116,243
Të bartura nga viti paraprak ⁶		7,280,641	6,382,842	16,383,352	5,903,886
Të hyrat vetjake ⁷	30,000,000	29,950,000	16,394,896	12,265,988	10,718,580
Donacionet e brendshme		12,315	10,699	4,700	4,800
Donacionet e jashtme		456,557	347,497	297,787	57,698
Të hyra nga huamarrjet		50,000			

- Buxheti final në raport me atë fillestar ishte rritur për 7,549,202€. Kjo diferencë është si rezultat i donacioneve brendshme, atyre të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 7,749,513€ si dhe zbritja e aplikuar në grantin qeveritar prej 200,311€ në pajtim me vendimet e Qeverisë. Zbritja kryesisht ka prekur kategorinë paga dhe mëditje si dhe një vlerë të ulët të shpenzimeve komunale; dhe
- Shpenzimi i grantit qeveritar paraqet një shkallë maksimale (gati 100%).

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	65,883,762	73,432,964	58,774,174	64,525,481	56,801,207
Pagat dhe Mëditjet	28,108,709	27,944,188	27,900,604	27,404,645	25,610,137
Mallrat dhe Shërbimet	7,393,190	7,475,737	7,417,749	9,008,155	7,872,882
Shërbimet komunale	1,793,000	1,791,300	1,791,297	2,079,910	1,609,849
Subvencionet dhe Transferet	1,816,810	1,949,218	1,655,659	1,621,155	4,791,642
Investimet Kapitale	26,772,053	34,272,521	20,008,865	24,411,616	16,916,697

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Shkalla e ekzekutimit të buxhetit ishte 80%, e përafërt me atë të vitit të kaluar edhe pse në shumë absolute ky ekzekutim është më i ulët për 5,751,307€.

⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁶ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁷ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Shkalla aktuale e ekzekutimit të buxhetit është e ndikuar nga realizimi jo i kënaqshëm i investimeve kapitale, ku vetëm 58% është shpenzuar këtë vit. Njëra nga arsyet është se i tërë fondi i investimeve kapitale është i planifikuar të mbulohet nga të hyrat vetjake. Sido që të jetë, me një angazhim shtesë, kjo shkallë do të përmirësohej dukshëm për rreth 20% apo 6.5 milion, meqë në fund të vitit nga i tërë potenciali shpenzues i të hyrave vetjake (të barturat dhe alokimi i inkasimeve të vitit aktual) rreth 78% është shpenzuar. Një arsye tjetër e mos ekzekutimit të projekteve sipas ligjit të buxhetit 2016 është se një numër i kontratave është nënshkruar në muajt e fundit të vitit.

Çështja 8 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura	Shkalla e realizimit të projekteve kapitale si dhe shpenzimi i mjeteve vetjake nuk ishte në nivel të kënaqshëm.
Rreziku	Ekzekutimi i dobët i buxhetit do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të fondeve në dispozicion, si dhe redukon efektivitetin e planeve të shpenzimeve sipas programeve. Për komunën, mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë me realizimin e më pak projekteve.
Rekomandimi 8	Kryetari duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të shkaqeve dhe arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale në 2016 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në 2017.

3.1.1 Të hyrat

Gjatë vitit 2016, komuna ka inkasuar të hyra të veta prej 24,243,686€, shifër kjo e cila paraqet një performancë më të mirë për 34% krahasuar me vitin e kaluar (18,035,992€). Kategoritë dominuese të të hyrave dhe dukshëm më të larta se sa në vitin paraprak, ishin tatimi në pronë (7,176,272€), taksat në leje ndërtimi (10,548,157€) dhe të legalizimit (568,352€), si dhe të hyrat nga shfrytëzimi i hapësirave publike (1,083,686€).

Nga pikëpamja e gjithmbarshme e shpenzimeve (58,774,749€), rreth 39% e tyre janë të mbuluara nga të hyrat vetjake. Kjo shkallë paraqet një mbulesë të shpenzimeve nga THV dukshëm më të lartë se sa mesatarja e të gjitha komunave. Pagesa e shpenzimeve nga të hyrat vetjake për vitin 2016 ishin 22,777,738€.

Në realizimin e politikave të përgjithshme mbi të hyrat, përmirësime të dukshme janë vërejtur në fushën e urbanizmit. Tërheqja e garancioneve tek dhënia e lejeve me këste ishte bërë në momentet e duhura në rastet kur obligimet nuk janë paguar me kohë nga investitorët. Gjithashtu, mangësitë e vitit të kaluar për arkëtimin e taksave për pranim teknik dhe kompensimit të komisioneve, nuk ishte përsëritur këtë vit.

Çështja 9 - Qarkullimi i mjeteve jo përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit - Prioritet i lartë

E gjetura Biblioteka e qytetit “Hivzi Sylejmani” dhe Teatri i Qytetit “Dodona” menaxhojnë financat e tyre në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e financave publike, rregulloren e shpenzimeve si dhe në kundërshtim me rregulloren për të hyrat. Këto dy institucione vartëse komunale mbledhin dhe shpenzojnë të hyrat përmes llogarive të tyre bankare si dhe në disa raste edhe me para në dorë. Biblioteka gjatë vitit 2016 të hyra nga anëtarësimet kishte 30,253€, ndërsa shpenzimet ishin 11,542€. Po ashtu, Teatri “Dodona” gjatë vitit 2016 kishte të hyra prej 8,832€ (përfshirë edhe të bartura nga viti kaluar) dhe shpenzime 6,851€. Të dy rastet ishin shpalosur në pasqyra.

Rreziku Kryerja e transakcioneve përmes bankave komerciale, dhe jo përmes LIVTh, shpie në keqdeklarim të të hyrave (edhe pse ishin shpalosur në pasqyra). Financimi i aktiviteteve të mësipërme është jashtë kornizës ligjore mbi shpenzimin e parasë publike dhe nuk ka siguri të mjaftueshme nëse mjetet vërtetë kanë përfunduar sipas qëllimit, si dhe nuk mundëson kontrollë adekuate ndaj këtyre burimeve. Për më tepër, mundësia e keqpërdorimit të këtyre mjeteve mund të ndodhë.

Rekomandimi 9 Edhe pse këtë vit është vërejtur një angazhim i Drejtorisë së Kulturës për të rregulluar dhe futur në sistem menaxhimin financiar të këtyre dy njësive, megjithatë, Kryetari duhet të veproj në drejtim të arritjes së këtij qëllimi. Gjithashtu, ne do të inkurajonim të bëhet një auditim i brendshëm për secilin Institucion, për të marrë siguri të mjaftueshme rreth mënyrës së mbledhjes së të hyrave dhe shpenzimeve, për dy vitet para-prake.

Çështja 10 - Mos efikasitet në barazimin e të hyrave - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë rishikimit të procesit të barazimit të të hyrave, kemi vërejtur se nuk ka kontrollë të mjaftueshme me rastin e ngarkim-shkarkimit mes shefit të ofiqarëve dhe ofiqarëve, për formularët e zbrazët për lëshuarjen e çertifikatave civile apo dokumente tjera. Pra, nuk bëhet monitorimi i ofiqarëve dhe barazimi me ta mbi atë se sa formular të zbrazët janë pranuar nga ofiqarët, sa prej tyre janë përdorë, cilat shuma të taksave janë inkasuar, sa persona janë liruar dhe sa prej formularëve janë asgjësuar.

Jo të gjitha drejtoritë⁸ që inkasojnë të hyra bëjnë barazimet me zyrtarin e të hyrave për të konfirmuar gjendjen e tyre. Si rezultat i këtyre mos barazimeve, në njërën prej mostrave për të hyrat në Drejtorinë e Kadastrit prej 1,788€, kjo Drejtori nuk ka mundur të na ofronte lëndën nën arsyetimin se kjo e hyrë nuk i takon kësaj drejtorie.

⁸ Drejtoria e Administratës, Infrastrukturës Lokale, Shërbimeve Publike, Kadastrit, Arsimit (pjesërisht), Inspeksionit dhe Sektori i tatimit në pronë.

Rreziku Mungesa e mbikëqyrjes në zyrat e gjendjes civile mund të ndikojë në keqpërdorimin e çertifikatave me rastin e lëshimit të dokumenteve civile. Mos barazimet e të hyrave, ndikojnë në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e klasifikimeve të mundshme në kode të gabuara të transaksioneve.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të inicoj vendosjen e procedurave me Agjencinë e Regjistrimit Civil në mënyrë që të krijohet një formë e përshtatshme harmonizimi midis formularëve të lëshuar dhe barazimeve me mbikëqyrësit, në mënyrë që të lihen gjurmë adekuate dhe të lehta për monitorimin e të hyrave të arkëtuara. Më tej, të sigurojë se barazimet ndër departamentale kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet sqarohen me kohë.

Çështja 11 - Të hyrat nga urbanizimi dhe tatimi në pronë - Prioritet i mesëm

E gjetura Në dosjet e pranuar për trajtimin e objekteve pa leje, komuna nuk kërkon nga aplikuesit të dorëzojnë dëshminë se të njëjtat kanë paguar të gjitha taksat që lidhen me atë pronë. Në dy raste kemi vërejtur që për të njëjtat prona për të cilat është dhënë leje legalizimi, sipërfaqet e ndërtesave nuk janë të njëjta me ato që janë evidentuar në sistemin e tatimit në pronë. Njëri objekt është i legalizuar për 371m² derisa për tatimin në pronë paguan për 190m² dhe rasti tjetër ku objekti është legalizuar për 396m² dhe tatim në pronë paguan për 250m². Kjo ka ardhur si mungesë e mos verifikimit të mjaftueshëm të pronave në terren për regjistrim të tatimit në pronë.

Në një rast tjetër të legalizimit, aplikuesi nuk e kishte fare të regjistruar objektin për pagesë të tatimit në pronë, ndërsa objekti i është legalizuar.

Departamenti i tatimit në pronë, edhe pse kishte planifikuar një numër të madh verifikimesh të pronave në terren, raporti i këtij sektori tregon që nuk janë bërë verifikimet e planifikuara. Sipas UA 03/2011 komuna duhet të verifikoj 1/3 e pronave të regjistruara.

Rreziku Mangësitë në dokumentacionin e kërkuar për legalizim si dhe mos verifikimi i pronave për qëllime të tatimit në pronë, rrit rrezikun që komuna të mos ketë të dhënat e duhura për të përcaktuar ngarkesat reale të tarifave ndaj qytetarëve.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj se Drejtoria e Urbanizimit dhe Sektori i tatimit në pronë komunikojnë efektivisht në mënyrë që të gjithë të legalizuarit për objektet ndërtimore, paguajnë njëkohësisht edhe vlerën e saktë të tatimit në pronë konform sipërfaqeve të verifikuara përmes dosjeve për legalizim. Kjo do të lehtësonte në një masë edhe procesin e verifikimit të pronave për tatimin në pronë.

Çështja 12 - Menaxhimi i qiradhënieve dhe hapësirave publike - Prioriteti i mesëm

E gjetura Komuna ka të lëshuara me qira 43 banesa për delegatë dhe nëpunës komunal. Përcjellja dhe menaxhimi i tyre bëhet pjesërisht nga Drejtoria e Financave si dhe nga Drejtoria e Pronës. Përkundër tarifave ekonomike në këto qira, jo të gjithë shfrytëzuesit kryejnë me rregull obligimet e tyre. Njëkohësisht, komuna nuk e administron mirë këtë çështje, duke mos i faturuar rregullisht si dhe duke mos marr veprime në rast mos pagese. Disa iniciativa për kompletim lëndësh ishin marrë nga Drejtoria e Pronës, në tetor 2016.

Dhënia e pëlqimit të shfrytëzimit të hapësirave publike për biznese dhe individë bëhet në baza sezonale (verore dhe dimërore), nga një komision i formuar nga kryetari. Faturimi për sezonën verore bëhet kryesisht në qershor, edhe pse shfrytëzimi i hapësirave publike nga bizneset dhe individët bëhet gjatë periudhës prill-shtator. Pra, inkasimi i mjeteve bëhet pas një kohe të shfrytëzimit të këtyre hapësirave nga bizneset ose individët, si pasojë e caktimit me vonesë (në fund të prillit) të komisionit për evidentim të shfrytëzuesve potencial të hapësirave publike nga komuna.

Rreziku Mos efikasiteti në marrjen e veprimeve me kohë për të faturuar, dhe për të caktuar komisionet për evidentim të hapësirave publike në posedim të shfrytëzuesve, ka efekte të drejtpërdrejta në shumat e mbledhura të tarifave të qirasë. Kjo mund të rrit rrezikun që komuna të humb të drejtën ligjore në inkasim apo të njëjtat të shndërrohen në borxhe të këqia.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj që zyrtarët e ngarkuar me menaxhimin e pronave komunale të ndërmarrin të gjitha mjetet juridike për inkasim të tarifave të përcaktuara me kontratë, ndërsa komisioni për evidentimin e shfrytëzimit të hapësirave publike duhet të bëhet para fillimit të sezonës verore.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Në përgjithësi është shënuar progres në menaxhimin e burimeve njerëzore, duke adresuar kështu rekomandimet për mos procedim të parregullt të pagesave, ripërtëritjen e kontratave për mësimdhënësit, mos largimin e punonjësve pa bazë të arsyeshme ligjore si proceset e përzgjedhjes së stafit në arsim e shëndetësi.

Çështja 13 - Zbatimi me vonesë i vendimeve të KPMSHC dhe azhurnimit të dosjeve të personelit - Prioritet i mesëm

E gjetura Në pesë raste, komuna ka zbatuar me vonesë (mbi 4 muaj) vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil (KPMSHC) për kthim në punë të zyrtarëve, edhe pse nuk kishte bërë ankimum ndaj atyre vendimeve. Gjatë këtyre muajve vlera e pagave është rimbursuar (11,203€) edhe pse nuk është shfrytëzuar kontributi i punonjësve për këtë periudhë.

Nevoja për azhurnimin e dosjeve (kryesisht në arsim) ende ekziston, përfshirë këtu dëshmitë mbi të dhënat personale, përshkrimi i punës, certifikatat që nuk janë në hetime, etj. Gjithashtu, në dosje mungonin vlerësimet e performancës së zyrtarëve komunal dhe në gjashtë raste kemi vërejtur se aktemërimet⁹ e shërbyesve civil duhet të përshtaten me rregulloren nr. 07/2010.

Rreziku Mos ekzekutimi me kohë i vendimeve të detyrueshme të këshillit, shkakton humbje financiare si rezultat i mos shfrytëzimit të punës që do duhej të bëhej nga punëmarrësit. Mos azhurnimi i dosjeve, mund të mos ofrojë informata të mjaftueshme për personelin, derisa mungesa e vlerësimeve, rrit rrezikun për ekzistencën e performimit të dobët të personelit, ndërkohë që menaxhmenti nuk ka njohuri dhe nuk mund të merr veprime përmirësuese.

Rekomandimi 13 Kryetari të siguroj se ekzekutimi i vendimeve të tilla bëhet me kohë në mënyrë që të shmangen humbjet e buxhetit komunal. Gjithashtu, dosjet e personelit të përmbajnë dokumentet e kërkuara dhe të aprovuara nga menaxhmenti i lartë i komunës dhe të aplikohet sistemi i vlerësimit të performancës për stafin komunal.

⁹ Akt emërimi nuk përmban protokollin e shpalljes së konkursit dhe të njoftimit të kandidatëve, adresën e punëtorit dhe gradën e nëpunësit.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet (përfshirë shpenzimet komunale)

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 9,267,037€, i cili ishte shpenzuar pothuajse në tërësi. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë shpenzimet komunale dhe të komunikimit, derivatet dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera si dhe një pjesë e ekzekutuar gjithashtu duke u bazuar në vendimet e gjykatave si dhe pagesat direkte nga Thesari, bazuar në nenin 39.2 të LMFP.

Çështja 14 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe direkte nga Thesari- Prioritet i lartë

E gjetura Në bazë të vendimeve gjyqësore, përmes përmbaruesit dhe pagesave direkte të Thesarit sipas nenit 39.2 të LMFP në vitin 2016 ishin shpenzuar nga kategoria e investimeve kapitale 255,197€ dhe nga mallra dhe shërbime 323,862€.

Sipas testeve të bëra, këto shpenzime kanë ndodhur për shkak të:

- Për shërbimin e sigurimit fizik të objekteve, kontrata kishte skaduar. Për këtë shërbim, kërkesa për inicim të prokurimit ishte bërë me vonesë dhe derisa gjatë procesit OE potencial kanë ankimuar disa herë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), kjo ka bërë që ky proces të zvarritet gjatë. Ndonëse, kishte skaduar kontrata me OE të mëparshëm, komuna ka bërë pranimin e shërbimeve deri në zgjedhjen e operatorit të ri. Edhe pse faturat nuk kishin kaluar afatin ligjor për pagesë (30 ditë kalendarike pas pranimin të faturës ose kërkesës për pagim sipas LMFP), përmbaruesi privat kishte vendosur në favor të operatorit që t'i bëhen pagesat. Megjithatë, nuk është vërejtur ndonjë veprim nga komuna për këto çështje;
- Për shërbimin e marimangës, në mungesë të kontratës valide, komuna kishte pranuar shërbime dhe nuk ka kryer pagesat. Prandaj, pagesa ishte kryer direkt nga Thesari;
- Për obligimet e sigurimit të automjeteve, që nga viti 2011, ishin ekzekutuar pagesa direkte nga Thesari. Në kuadër të këtyre pagesave kishte edhe fatura¹⁰ të cilat ishin paguar edhe më herët (1,121€). Komuna nuk kishte ndërmarrë veprim brenda afateve ligjore për të kundërshtuar vendimin e përmbaruesit; dhe
- Për mungesë të mjeteve tek buxheti i mallrave dhe shërbimeve, pagesat direkte nga Thesari ishin ekzekutuar për shpenzimet e naftës, servisimin dhe mirëmbajtjen e aparaturës shëndetësore dhe furnizimin me barna dhe material shpenzues mjekësor.

¹⁰ Faturat: nr. 622/11, nr. 150/14, nr.166/2014, nr. 423/13 dhe nr. 00371/04-2014.

Rreziku Pagesat e ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 të LMFPP janë domethënëse për buxhetin e komunës dhe ndikojnë në lëkundje të bilancit buxhetor. Mos angazhimi i mjaftueshëm i zyrës ligjore të komunës për të kontestuar vendimet aty ku kishte bazë ligjore, rrezikon dëmtimin e buxhetit dhe pagesa të tjera administrative. Kjo rrit rrezikun për pagesa jashtë kodeve të planifikuara dhe mos realizimin e projekteve për shkak të ridestinimit të shpenzimeve buxhetore.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të shtojë kontrollet ndaj menaxhimit të kërkesave për shërbimet e domosdoshme të komunës në mënyrë që t'i siguroj me kohë këto shërbime. Po ashtu, me rastin e planifikimeve buxhetore, zyra ligjore duhet të shqyrtoj me kujdes të gjitha detyrimet e prapambetura të komunës dhe të vlerësoj shumat e mundshme të daljes së parasë nga kontestet e hapura gjyqësore, dhe të njëjtat të përfshihen në kuadër të buxhetit vjetor. Për rastin e sigurimit të automjeteve, komuna të rishikoj pagesat e bëra ndaj OE dhe të ndërmerr veprimet e duhura për kthimin e mjeteve.

Çështja 15 – Furnizimi i dokumentacionit shkollor - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Prishtinës ka bërë furnizimin me dokumentacion pedagogjik (si ditarë, libra amë dhe regjistra tjerë) në vlerë 13,294€. Për këto furnizime nuk është zhvilluar procedurë e prokurimit, por komuna është mbështetur sipas një vendimi të Ministrisë së Arsimit, i cila ka caktuar OE “Dukagjini” Shpk për botimin e dokumentacionit të tillë¹¹.

Rreziku Furnizimi i tillë, pa u siguruar mbi procedurat dhe lëndën (vendimin) në bazë të së cilës bëhet furnizimi, eliminon transparencën dhe bie ndesh me rregullën mbi shpenzimin e parasë publike.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurohet që vendimi dhe çmimet e paguara kanë mbështetje ligjore, dhe nëse jo të inicojë bisedimet me Ministrinë në mënyrë që furnizimeve të tilla t'i paraprijnë procedura të hapura prokurimi.

¹¹ Vendimi i datës 01.08.2016, për të cilën nuk është konstatuar se janë zhvilluar procedura të prokurimit.

Çështja 16 – Angazhimet sipas kontratave për shërbime të veçanta – Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas regjistrit të pagesave, gjatë këtij viti janë angazhuar 210 zyrtarë me kontratë për shërbime të veçanta¹² që paraqet një numër të reduktuar nga viti i kaluar (276). Me rastin e përzgjedhjes së këtyre individëve, nuk ishin zbatuar procedura të thjeshtësuara të rekrutimit.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat. Mungesë e konkurrencës së mirëfilltë, cilësia e shërbimeve të ofruara mund të jetë e nivelit të dobët dhe objektivat e organizatës të mos arrihen.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave.

Çështja 17 – Dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Tek dy raste të testuara, “Furnizimi me dezinfektues medicinal për duar për nevoja të QKMF-së” (2,190€) si dhe “Manifestimi i ditës së QKMF-s 21 Qershori” (7,260€), procedurat e prokurimit janë zhvilluar pa aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA). Deklarata e disponueshmërisë së mjeteve nuk është nënshkruar nga ZKA dhe ZKF siç parasheh LPP, por nga drejtori i QKMF-së, zyrtari financiar dhe i prokurimit në kuadër të QKMF-së. Gjithashtu kontratat nuk nënshkruhen nga menaxheri i prokurimit të komunës, por nga zyrtari i prokurimit të QKMF-së.
- Tek kontrata „Furnizim me artikuj ushqimor për “Kuzhinën qendrore të institucioneve parashkollore” në vlerë 40,373€, menaxheri i kontratës ka bërë aprovimin e furnizimeve jashtë kontratës në vlerë prej 1,044€, pa një aprovim paraprak nga ana e ZKA-së dhe menaxherit të prokurimit.
- Rreziku** Prokurimi pa aprovim të ZKA, si dhe tejkalimet e kontratave, përveç që është në kundërshtim me LPP, mund të ndikojë që komuna të hyjë në obligime financiare të pa planifikuara.
- Rekomandimi 17** Kryetari duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe inicimi i procedurave të prokurimit të aprovohet sipas rregulloreve të prokurimit dhe të mos ndodhin furnizime jashtë kontratave.

¹² Në regjistrin komunal ceket se janë të angazhuar si zyrtarë në zyrat e gjendjes civile, zyrtarë në kuzhinën e institucioneve parashkollore, zyrtarë për legalizim, zyrtarë tjerë në urbanizëm, zyrtar i kulturës, zyrtarë inspekcioni, regjistruar të ndërtimeve pa leje, anketues të tatimit në pronë, performues të festave, etj.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,949,218€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 1,655,659€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e fermerëve për serra, kompensim të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, shpenzimet për aktivitete kulturore dhe sportive dhe tjera.

Vërehet një përmirësim i dukshëm në krahasim me vitin e kaluar lidhur me menaxhimin e kësaj kategorie dhe kontrolleve që duhet zbatuar, megjithë prezencën e disa mangësive.

Çështja 18 – Sfidat në mbikëqyrjen e subvencioneve dhe transfereve - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna ka subvencionuar projektin për festën e muzikës “21 Qershori” me 10,000€. Edhe pse ishte përcaktuar në kontratën përcjellëse mes komunës dhe përfituesit, nuk janë ofruar raporte kthyesë narrative apo financiare/dëshmitë përcjellëse të cilat do të vërtetonin nëse subvencioni është shpenzuar për qëllimin e caktuar.

Rast i ngjashëm ishte edhe me subvencionin në vlerë 1,710€ në llogarinë e drejtorit artistik të teatrit mimik, ku komuna nuk kishte siguruar dëshmi mbështetëse për të vërtetuar se fondet janë shpenzuar sipas qëllimit të dhënë.

Rreziku Mos raportimi dhe monitorimi i shpenzimit të subvencioneve, përveç që mund të shpie në keq përdorim të qëllimit të subvencioneve, lë hapësirë për mungesë të përgjegjësive nga drejtoritë/programeve nga të cilat janë shpenzuar fondet.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet t’i forcojë kontrollet në atë mënyrë që për çdo subvencion të dhënë merren dëshmi të mjaftueshme dhe relevante që vërtetojnë se subvencioni është shpenzuar sipas qëllimit të caktuar.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 34,272,521€. Kjo shumë e buxhetuar është shpenzuar në shkallë 58% apo 22,008,865€ e cila në vitin paraprak ishte në nivel prej 62%.

Pjesa më e madhe e projekteve kapitale kishte të bënte me ndërtimin e rrugëve, objekteve arsimore, mirëmbajtje investive, transfere kapitale tek entitetet publike dhe tjera.

Çështja 19 – Ridestitim i shpenzimeve te projektet kapitale pa aprovim paraprak të kuvendit – Prioritet i lartë

E gjetura Kontrata për projektin “Ndërtimi i kolektorit të lumit Prishtina dhe rruga mbi kolektor”, u nënshkrua më 09.08.2016 në vlerë 2,192,855€. Për vitin 2016 ishte buxhetuar në kodin e PIP¹³ 43193 në vlerë 950,000€. Mjete të shpenzuara janë gjithsej 949,600€, megjithatë, vetëm 100,000€ prej tyre janë destinuar për këtë projekt, ndërsa pjesa tjetër prej 849,600€ është shpenzuar për projekte tjera pa aprovimin e lëvizjeve të mjeteve, dhe atë si: sanimi i gropave, ndërtime të rrugëve të ndryshme dhe “Ndërtimi i bulevardit mbi Kurriz”.

E gjetura Mos azhurnimi i PIP-it do të zvogëlojë zbatimin efektiv të planeve të parapara të shpenzimeve kapitale, dhe pasqyrim të pasaktë të projekteve të realizuara brenda kategorisë së investimeve kapitale.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të siguroj se ndryshimet/ridestitimet në projektet kapitale të komunës të prezantuara në Tabelën e buxhetit 4.2 “Financimi i projekteve kapitale” të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, ashtu siç e parasheh ligji.

Çështja 20 – Certifikimi i pagesave – Prioritet i lartë

E gjetura Ekzekutimi i pagesave në vlerë 8,514€ dhe 7,029€ për trajtimin e qenve endacak, ishte bërë sipas çmimit prej 33€ për një qen të trajtuar. Përkundër faktit që shuma 33€ përbëhet prej 13 specifikave për trajtime të ndryshme¹⁴, në raport pranimi nuk janë paraqitur cilat pozicione për shërbime janë realizuar për një qen, por vetëm sa njësi/qen janë trajtuar. Si rrjedhojë, operatorit i është paguar çmimi total i të gjitha shërbimeve, pavarësisht nëse janë kryer të gjitha shërbimet e kontraktuara.

¹³ Projekti i Investimeve Publike.

¹⁴ Si sterilizimi 9.8€ ndërsa kastrimi 6.8€, zënia me injeksion 2.3€ ndërsa zënia me kurth 1.7€, etj.

Rreziku Raportet jo të plota për konfirmimin e pranimit të shërbimeve të kontraktura, rrit mundësinë e pagesave edhe për shërbimet që nuk janë pranuar.

Rekomandimi 20 Kryetari duhet të siguroj që menaxherët e kontratës dhe çertifikuesi i pagesave, do të sigurojnë raporte të plota lidhur me pranimin e shërbimeve, dhe vetëm pasi të jetë konfirmuar se shërbimet janë pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur, pagesat të çertifikohen.

Çështja 21 - Dobësitë në zotimin e mjeteve dhe urdhërblerjeve- Prioritet i lartë

E gjetura Nga mostrimi që kemi bërë, në pesë raste, zotimi¹⁵ i mjeteve ishte më i ulët se kontrata. Derisa në testimet tjera të pagesave është vërejtur se në disa raste urdhërblerja është bërë pas pranimit të faturës.

Rreziku Zotimi i mjeteve më i ulët se obligimi kontraktues dhe krijimi i urdhërblerjes pas faturimit/përfundimit të punëve mund të rezultojë me vonesa në pagesa dhe rrezikon që projektet të mbesin të parealizuara.

Rekomandimi 21 Kryetari duhet të siguroj që kontratat nuk nënshkruhen pa sigurimin paraprak të fondeve. Gjithashtu, urdhërblerja të krijohet dhe përgatitet pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata.

Çështja 22 - Pagesat për projektet e bashkëfinancuara - Prioritet i mesëm

E gjetura Krahasuar me vitin e kaluar, menagjimi i projekteve të bashkëfinancuara me donatorë ka shënuar progres. Por, në tri raste¹⁶ kemi vërejtur se janë kryer pagesa në llogarinë e bashkëfinancuesve, bazuar vetëm në marrëveshje mes komunës dhe donatorit. Sfidat në menaxhimin e këtyre projekteve janë tek sigurimi paraprak i raporteve për pranime të furnizimeve/shërbimeve para se të bëhen pagesat, ndonëse kërkesat nga donatorët janë që më parë të bëhet transferi i mjeteve. Megjithatë, pas përfundimit të pagesave ekzistojnë raporte për realizimin e projekteve.

¹⁵ Projektet "Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kanalizimit fekal në rrugën mbi lumin Prishtina", kontrata ishte 2,192,855€, ndërsa zotimi 100,000€; "Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore" kontrata ishte 1,969,163€, ndërsa zotimi 200,000€; "Ndërtimi i stadiumit të futbollit në Hajvali- Faza II" kontrata ishte 414,829€, ndërsa zotimi 50,000€; "Ndërtimi i kolektorit betonarme për largimin e ujit atmosferik dhe kanalizimi fekal në rrugën mbi lumin Mat" kontrata ishte 1,696,063€, ndërsa zotimi 100,000€; dhe "Renovimi i garazhës së NK Trafikut Urban " kontrata ishte 622,496€, ndërsa zotimi ishte 200,000€,

¹⁶ Gratë në Biznes për realizimin e projektit të tregut mobil të fermerëve; Help-Hilfe për mbështetje, stabilitet socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikrobiznesit në Kosovë; dhe Trafiku Urban (IVECO) për blerjen e autobusëve.

Rreziku Duke qenë se komuna nuk posedon mekanizma garantues se marrëveshjet do të realizohen siç janë përcaktuar, ekziston rreziku potencial që marrëveshjet të mos realizohen, objektivat të mos arrihen, dhe fondet e shpenzuara të mos kthehen.

Rekomandimi 22 Kryetari duhet të konsideroj se marrëveshjet për projektet e bashkëfinancuara do të kenë një siguri për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, përfshirë kërkesat e qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit para se të bëhen transferet e mjeteve.

Çështja 23 – Dobësitë në prokurim dhe kryerje të shërbimeve – Prioriteti i mesëm

E gjetura Te furnizimi dhe montimi i aparatit të rentgenit për nevojat e QKMF-së ishte kërkuar në specifikimet teknike që rentgeni t'i ketë katër kaseta digjitale, të cilat sipas menaxheres së kontratës është bërë gabim në specifikat e aparatit pasi që kjo aparaturë digjitale punon vetëm me një kasetë dhe nuk janë të nevojshme edhe 3 kaseta tjera të kërkuara. Njësia kërkuese në pamundësi të definimit të saktë për nevojat e rentgenit, si dhe kontroleve të dobëta nga prokurimi para inicimit të procedurave të tenderimit, kanë ndikuar në lëshime të pozicionit dhe janë bërë kosto shtesë për komunën, duke paguar 3 kaseta të cilat nuk janë të nevojshme.

Kontrata “Shërbimet teknike për organizimin e festës së 1 Qershorit ” (9,865€) ishte nënshkruar më 03.06.2016, ndërsa shërbimet janë pranuar në datat 1-3 qershor 2016.

Tek kontrata “Pjesa artistike për 1 Qershorin, ditën e fëmijëve ”, e nënshkruar në shumën 9,640€ më 02.06.2016, menaxheri i kontratës është caktuar më 08.06.2016, ndërsa raporti i pranimit të shërbimeve me datë 06.06.2016.

Rreziku Specifikat jo adekuate rrezikojnë që të gjenerojnë shpenzime shtesë të panevojshme apo të merret vlerë e dobët e shërbimeve për paratë e dhënë.

Pranimi i shërbimeve para nënshkrimit të kontratës mund të ndikojë që pranimi të bëhet për shërbime të cilat nuk janë kontraktuar, duke krijuar dëme të pa arsyeshme financiare.

Rekomandimi 23 Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit para inicimit të procedurave të prokurimit të rishikojë kërkesën e njësies kërkuese dhe aty ku nuk është kërkesa e përshtatshme, ta kthej tek njësia kërkuese për rishikim, në mënyrë që kërkesat të jenë të matshme dhe të pranueshme për furnizimet.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Komuna kishte bërë përmirësime të dukshme sa i përket regjistrimit të pasurive komunale. Komuna ka përmbushë rekomandimin e vitit të kaluar që pasuritë e identifikuara nga komisioni që ishte formuar në vitin 2012 të futen në regjistrin e SIMFK-së. Komuna ka arritur të shtojë pasurinë nga 111,035,848€ që kishte në vitin 2015, në 2,455,524,534€ në vitin 2016.

Çështja 24 - Menaxhimi i pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura Përkundër progresit të bërë dhe regjistrimeve të shumta nga zyrtari i pasurisë, komuna ende nuk ka arritur ta ketë një regjistër të plotë të pasurisë. Komuna ka të angazhuar vetëm një zyrtar të pasurisë.

Komuna nuk ka procedurë të brendshme të shkruara për menaxhimin e pasurive, siç kërkohet me rregulloren për menaxhimin pasurisë 02/2013.

Moduli E-pasuria përdoret vetëm për regjistrimin e mallit në depo, e jo për pasuritë nën 1,000€. Por, zyrtari i pasurisë posedon një regjistër të përgjithshëm të pasurive jo-kapitale në formë të një data baze në Excel.

Në dy marrëveshje për kompensimin e parcelave kadastrale të planifikuara për interes publik (ndërtime kolektive), gjithsej 805m² për kompenzim të pronës private ishin regjistruar në kadastrë si pronë komunale, mirëpo nuk ishte e regjistruar edhe në SIMFK. Kjo, si pasojë e mungesës së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Kadastrit apo edhe asaj të Urbanizmit me zyrtarin e pasurisë.

Një minibus i marrë donacion në vitin 2011 nuk ishte në regjistrat e pasurisë.

Objektet: 43 banesa komunale të dhëna në shfrytëzim, ish-objekti i gjykatës së Apelit, ish-objekti i gjykatës komunale, ndërtesa ku ndodhet drejtoria e inspeksionit dhe AKP, ende nuk figurojnë në regjistrat e pasurisë pasi që nuk është bërë vlerësimi i tyre. Në regjistrat kadastral është e paraqitur vetëm pronësia komunale për tokën.

Rreziku Mos përmbushja në tërësi e rregullores për menaxhimin e pasurisë, ku mungon regjistrimi total i pasurisë vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.

Rekomandimi 24 Kryetari duhet të siguroj bashkëpunimin e drejtorive për informimin e përvetësimeve të pasurive të reja, që zyrtari i pasurisë të ketë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin në SIMFK. Duhet funksionalizuar moduli E-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€ si dhe evidentimi i stoqeve, përfshirë të gjithë sektorët.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2016, llogaritë e arkëtueshme (LI/ A) ishin 47,087,614€. Llojet kryesore të LI/ A ndaj komunës janë: a) tatimi në pronë; b) lejet ndërtimore, c) qiraja dhe një shumë për shpronësim nga Ministria e Planifikimit Hapësinor. Në përgjithësi LI/ A kishin rënë krahasuar me vitin e kaluar, e cila është ndikuar nga zbatimi i ligjit për faljen e borxheve të tatimit në pronë.

Çështja 25 – Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna inkason të hyra nga taksat në biznes dhe shuma e inkasuar në këtë kod ekonomik ishte mjaft e vogël (83,887€), derisa në PFV nuk ishin paraqitur borxhet e pa mbledhura nga këto biznese. Ky shqetësim është komunikuar me menaxhmentin, por konsolidimet e duhura nuk janë bërë ende.

Sa i përket të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë, sistemi softuerik i të cilave menaxhohet nga Departamenti Qendror i Tatimit në Pronë, pranë MF, kohëve të fundit është vazhdimisht duke iu nënshtruar ndërhyrjeve në sistem për të harmonizuar ndikimet nga falja e borxheve dhe si proces është mjaft sfidues. Tek një lëndë e një tatimpaguesi, në bashkëpunim me zyrën komunale të tatimit në pronë kemi hasur në shuma kundërthënëse sa është saldo e borxhit sipas sistemit dhe sa do duhej të ishte sipas kalkulimeve manuale. Fatura sipas sistemit ka gjeneruar borxh të mbetur rreth 800€, derisa sipas kalkulimeve tona del të jetë rreth 1,300€. Për kalkulimet manuale për tatimpaguesit tjerë, ne nuk mund të ofrojmë siguri për vlerën e paraqitur të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë.

Rreziku Paraqitja jo e saktë e shpalosjeve shpie në një keq pohim të pozitës financiare dhe llogarive, dhe në vitet në vijim, mund të ndikojë opinionin e auditimit. Pjesa e tatimit në pronë është mjaft e ndjeshme për qytetarët, dhe gabimet e tilla, mund të kenë ndikim financiar ndaj obligimeve të qytetarëve.

Rekomandimi 25 Kryetari duhet të siguroj se për të arkëtueshmet e taksave në biznes krijohet një grup pune që në hollësi do të analizonte gjendjen e këtyre llogarive, ku do të shqyrtonte evidentimin, faturimin dhe mekanizmat e inkasimit në mënyrë që në të ardhmen komuna të ketë bazë të mjaftueshme ligjore për ndjekje të bizneseve të papërgjegjshme në pagesën e kësaj takse. Mangësitë e identifikuar në sistemin e tatimit në pronë të diskutohen me departamentin përkatës pranë MF në mënyrë që qytetarët të kenë një gjendje të saktë për obligimet tatimore ndaj komunës.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara në PVF të vitit 2016 ishte 1,696,652€ apo 48% më i lartë se në vitin paraprak (1,142,513€).

Përveç borxheve, komuna ka detyrime kontingjente lidhur me konteste të ndryshme gjyqësore që parallogariten në vlerë rreth 4,897,065€ që krahasuar me vitin e kaluar (8,298,000€) kanë një tendencë rënie prej 40%. Komuna është duke e zhvilluar çasjen e saj për trajtimin e këtyre detyrimeve dhe e ka të qartë mundësinë e shndërrimit të detyrimeve kontingjente në obligime faktike dhe ndikimit në situatën financiare të komunës.

Në fazën e parë kemi vërejtur se obligimet janë raportuar vetëm për muajt janar, shkurt dhe shtator, si dhe tek drejtorja e arsimit ishin paraqitur obligimet totale për furnitorë, e jo sipas faturave. Në fazën e dytë janë vërejtur përmirësime në raportimet mujore tek MF.

Çështja 26 – Raportimi i obligimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Shkakut i mos protokolimit të të gjitha faturave të pranuar, është identifikuar evidentim i dobët i obligimeve ndaj OE. Ka mungesë të një raportimi të strukturuar dhe formal në mes të drejtorive dhe udhëheqësit të sektorit për buxhet dhe financa, në baza mujore.
- Për shpenzime komunale, shpenzimi për ngrohje në shumë 180,000€ nuk është raportuar deri në shtator 2016 edhe pse faturimi është bërë për periudhën 2013 dhe 2014. Në raportim nuk ceket si obligim i vonuar në pagesë, por kontest gjyqësor.
- Rreziku** Mos protokolimi i të gjitha faturave dhe rrugët jo formale të komunikimit mes drejtorive dhe zyrtarit përgjegjës rrezikon identifikimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të obligimeve financiare.
- Rekomandimi 26** Kryetari duhet të vendos një sistem të protokolimit të çdo fature të pranuar nga operatorët. Po ashtu, të siguroj se konfirmimet formale për faturat e papaguara bëhen nga departamentet përgjegjëse ndaj kërkesave të ZKF-së.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyrat financiare	1. Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rrezikut domethënës lidhur me plotësinë e pasurive, si dhe keq-klasifikimin e shpenzimeve dhe pagesat në llogari të donatorëve që ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari i Komunës.			Ka ende mangësi tek shpalosjet e PF.
	2. Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, para se në draft PVF të jenë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Cilësia e PF ishte më e mirë se viti i kaluar.	

Qeverisja	<p>3. Drejtori i Urbanizmit kishte themeluar një komision për pranim teknik të objekteve të pallatit të drejtësisë dhe kishte nënshkruar kontrata me anëtarët e këtij komisioni prej të cilëve 10 ishin punonjës të komunës ndërsa 5 ishin të jashtëm. Kontraktimi dhe kompensimi i anëtarëve të këtij komisioni nuk ishte në pajtim me ligjin në fuqi. Shpenzimet për këtë komision i kishin kushtuar komunës 106,346€ ku nga kjo shumë 2,377€ ishin shpenzime të përmbarimit. Ky shpenzim ishte bërë sipas Ligjit të vjetër për Ndërtim Nr. 2004/37 ndërsa me Ligjin e ri Nr. 04/L-110, pranimi teknik duhet të bëhet nga inspektorati i komunës. Kjo ka ndodhur për shkak të vonësave në harmonizimin e akteve nënligjore sipas kërkesave të ligjit të ri që ka rezultuar me veprime që nuk kanë pajtueshmëri ligjore. Për më tepër, pagesat për 10 punonjësit e komunës (anëtarë të këtij komisioni) janë në kundërshtim me nenin 80 LMFPF, ku ndalohet kompensimi shtesë për angazhim të stafit në komisione.</p>	Po		
	<p>4. Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të siguroj se departamenti i financave posedon të gjitha evidencat mbi detyrimet. Pagesa e detyrimeve të prapa mbetura, duhet të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha faturat.</p>			Këtë vit janë rrit obligimet për 48%.
	<p>5. Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse plani i veprimit për vitin e kaluar nuk është dorëzuar në ZKA dhe pse rekomandimet e auditimit nuk janë zbatuar. Ne rekomandojmë që hartimi i planit të veprimit për vitin 2015 të bëhet me kohë dhe të përcaktoj saktë afatet kohore për adresim të rekomandimeve, të përcaktoj stafin përgjegjës, me fokus fillestar në çështjet më të rëndësishme të ngritura nga auditimi.</p>		Disa rekomandime ende mbesin te pazbatuara.	

	6. Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë permanente. Auditimi i brendshëm duhet të aplikoj një proces rishikimi për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Ende nuk ka plotësuar listën kontrolluese të vetëvlerësimit.
	7. Kryetari duhet të siguroj se në bashkëpunim me ekipin e tij menaxhues do të diskutoj dhe identifikoj rreziqet e nivelit të lartë në të gjithë sektorët e komunës, të përcaktoj masat dhe veprimet parandaluese, si dhe të delegoj përgjegjësitë për menaxhimin e rrezikut të stafi përkatës. Gjithashtu, duhet të siguroj raportime dhe shqyrtime të rregullta për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Ende ka mangësi në identifikimin e rreziqeve dhe përcjelljen e tyre.
	8. Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.		Disa komponente financiare dhe operative nuk raportohen tek menaxhmenti.	
Auditimi i brendshëm	9. Kryetari duhet të siguroj se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet dhe materializohet me trajtimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme se kontrollet operojnë në mënyrë efektive dhe ashtu siç janë dizajnuar. Në funksion të maksimizimit të përfitimeve nga auditimi i brendshëm, ne sugjerojmë edhe themelimin e Komitetit të Auditimit brenda një afati të arsyeshëm.			NJAB nuk është funksionale, si dhe nuk ka kryesues të Komitetit të Auditimit.
Ekzekutimi i buxhetit	10. Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore rishikohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivele të planifikuara. Këtij aktiviteti duhet t'i paraprijë një proces i mirëfilltë i planifikimit, përcaktimit të objektivave dhe ndërlidhjes së tyre me buxhetin e komunës.		Ekzkeutimi i kapitaleve ende nuk ishte në nivelin e duhur.	

	11. Kryetari duhet të analizoj arsyet e mos realizimit të hyrave dhe trendin e të hyrave gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëj një planifikim objektiv dhe të realizueshëm. Më tej, i njëjti plan duhet të pasohet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim.		Ekzekutimi i buxhetit në disa kategori ka pasur mangësi.	
	12. Kryetari duhet të siguroj se përdorimi i fondeve të bëhet në përputhje me ndarjet fillestare të buxhetit, dhe në rast të devijimeve të tilla, shpenzimet duhet të prezantohen dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore duke ofruar një transparencë të plotë për përdoruesit e pasqyrave financiare.			Ekziston një shkallë e ulët e shpenzimeve kapitale vetëm 58%.
Prokurimi	13. Kryetari të analizoj pse nuk janë zbatuar kërkesat e prokurimit dhe nga departamentet përkatëse të siguroj kontrolle efektive që me rastin e hartimit të kërkesës, specifikimit, paramasës dhe paralogarisë, të përcaktohen saktë të gjitha pozicionet e punëve apo shërbimeve, me qëllim të evitimit të pagesave të parregullta.			Ka dobësi në kontrolle efektive nga prokurimi me rastin e hartimit të paramasës.
	14. Kryetarin të siguroje se shërbimi i prokurimit do të zbatohet në mënyrë strikte kërkesën që para fillimit të secilës procedurë të prokurimit për punë/ndërtim është bërë hartimi i projektit ekzekutiv të ndërtimit.	Po		
	15. Kryetari të siguroj që me rastin e hartimit të planeve detale për projekte, të bëhet rishikimi rigoroz i tyre në mënyrë që të mos ketë ndryshime gjatë ekzekutimit dhe të mos bëhen shpenzime të dyfishta për të njëjtin shërbim.	Po		
	16. Kryetari të siguroj se zhvillimi i procedurave të prokurimit do t'u nënshtrohet kontrolleve rigorozë që nga inicimi i procesit deri tek implementimi i kontratave.	Po		
	17. Kryetari duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe të ushtrojë mbikëqyrje të përshtatshme për menaxhim cilësor të kontratave.			Ende ka pagesa direkte nga Thesari.

Shpenzimet jo përmes prokurimit	18. Kryetari duhet të sigurojë që kjo praktikë të mos përsëritet me rastin e marrëveshjeve të reja, ndërsa për marrëveshjet në implementim e sipër, të forcohen kontrollet, sidomos në kërkesën e raporteve periodike nga partnerët për progresin e arritur kundrejt fondeve të shpenzuara. Në aranzhimet vijuese, për të gjitha projektet e ngjashme, komuna duhet të merr rolin e autoritetit kontraktues, dhe t'i udhëheq vet të gjitha procedurat që nga iniciimi deri në përfundimin e projekteve. Komuna duhet të përgatit raportet përfundimtare për realizimin e projekteve të financuara deri tani, dhe në auditimin e radhës, ato do të jenë pjesë e veçantë e rishikimeve.		Marrëveshjet paraprake ende janë në zbatim, derisa marrëveshje me Helvetas është ekzekutuar sipas rregullave.	
	19. Kryetari duhet të përcaktojë se pse pagesat nuk ka qenë subjekt i kontrolleve të duhura në përputhje me kërkesat ligjore, dhe duhet t'i forcoj kontrollet për të siguruar që veprimet e tilla të evitohen.	Po		
Pagat dhe mëditjet	20. Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave dhe akterët tjerë.		Është reduktuar numri i të angazhuarve.	
	21. Kryetari duhet të zgjidhë këtë jokonsistencë, dhe të përcaktojë nëse këto janë vetëm raste të izoluara apo një dukuri e përhapur. Varësisht nga gjendja, të forcohen edhe kontrollet për të parandaluar rastet e tilla.	Po		
	22. Kryetari duhet të siguroj që zyra e personelit do të aplikoj të gjitha kërkesat e rregulloreve të shërbimit civil për kompletimin e dosjeve, duke përfshirë edhe vlerësimet e rregullta të performancës për gjithë stafin.			Ka mangësi në kompletimin e dosjeve të personelit.

	23. Kryetari duhet të marr masat për ripërtëritjen e kontratave si element bazë për vazhdimin e marrëdhënies së punës. Në të kundërtën, pagat nuk duhet të paguhen.	Po		
	24. Kryetari të siguroj se proceset e rekrutimit do të bazohen në kritere të qarta të përzgjedhjes si dhe të demonstroj transparencë dhe objektivitet me rastin e selektimit të kandidatëve.	Po		
	25. Me rastin e vendimmarrjes, lidhur me shkeljet e detyrave të punës nga ana e stafit, Kryetari të siguroj se janë zbatuar të gjitha procedurat e duhura dhe vendimmarrja është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.	Po		
Subvencione dhe Transfere	26. Kryetari duhet të siguroj se rregullorja aktuale për subvencionet do të ndryshohet dhe plotësohet në pjesët ku janë identifikuar paqartësitë dhe të përcaktohen kriteret, kërkesat, procedurat dhe dokumentet e duhura për ndarjen dhe kontrollin e fondeve të dhëna për subvencione.		Ende nevojitet angazhim në sigurimin e raporteve kthyesë dhe ndryshimin e rregullores.	
Të hyrat	27. Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pronat e dhëna me qira, monitorohen në kuptimin e pagesës së qirasë në baza të rregullta mujore.			Nuk ka menaxhim të mirë të qirave për pagesë.
	28. Kryetari duhet të siguroj respektimin e rregullave dhe kritereve dhe të vendos kontrole më efektive në sektorin e ndërtimit me qëllim të trajtimit të barabartë dhe respektim të ligjit. Gjithashtu, procesi i shpronësimit të bëhet në përputhje me rregullat.		Në mungesë të mjeteve buxhetore shpronësimi ende bëhet në bazë koeficienti me kompenzim metrash ndërtimi.	
	29. Kryetari duhet të forcoj kontrollet që të gjitha njësitë vartëse të komunës të derdhnin të hyrat në Llogarinë e Vetme të Thesarit, me qëllim të evitimit të keqpërdorimit të tyre.			Biblioteka dhe teatri nuk derdhnin të hyrat përmes LLVTH.

	30. Kryetari të siguroj vendimmarrje ligjore në proceset e realizimit të të hyrave, dhe ngarkesa e qytetarëve të bëhet në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.	Po		
	31. Kryetari duhet të rishikoj kontrollet dhe të aplikoj aktivitete shtesë për ekzekutimin e garancioneve sipas marrëveshjes, me qëllim që inkasimi i të hyrave të bëhet me kohë.	Po		
	32. Kryetari duhet të vendos kontrolle mbi verifikimin e pronave, ndryshimet të përcillen në kohë dhe ngarkesat për tatimpaguesit të jenë të sakta, me qëllim të realizimit korrekt të tatimit në pronë.			Nuk janë bërë verifikimet e planifikuara.
	33. Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet mbi menaxhimin e procesit të të hyrave nga ofiqaritë dhe të vendos kontrollet e duhura me qëllim të parandalimit të mundësisë për keqpërdorime.		Pjesërisht, Ende duhet të vendosen kontrolle në shërbimin e ofiqarisë.	
Pasuria	34. Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të siguroj regjistrim të saktë dhe të plotë të tyre. Çështja e pasurive të identifikuara, por të pa regjistruara në SIMFK, duhet të diskutohet me Ministrinë e Financave dhe të gjinden modalitetet për përfshirjen e tyre në sistem.		Pjesërisht, Ende mbetet sfidë plotësia e regjistrimit.	
Ll/A	35. Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e trendit të rritjes së këtyre llogarive dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të vendosen për të mundësuar identifikimin dhe arkëtimin e borxheve të akumuluar, përfshirë edhe veprimet ligjore.			Komuna ka një shumë të madhe të llogarive të arkëtueshme, ende nuk ka marrë veprime për inkasim të tyre.
Ll/P	36. Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që departamenti i financave të evidentoj dhe paguaj me kohë të gjitha detyrimet, ndërsa detyrimet kontingjente të trajtohen me kujdes me rastin e planifikimeve të ardhme buxhetore.		Nuk protokolohen të gjitha faturat dhe linjat e raportimit duhet të përmirësohen.	

Shtojca IV: Letër e Konfirmimit

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E PRANIMIT / DATE RECEIVED		15.06.2017	
Klasifikim / Classification	Klasifikim / Classification	Dr. Prot. / Prot. No.	Klasifikim / Classification
22	22-0	659	1

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS	
KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRISHTINA	
14-06-2017	
01-052/01-0143092/17	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 14.06.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Shpend Ahmeti

